

Home > Aktualitet > Sherr me menaxherin e lokalit, klienti qëllon me armë në ajër, tenton t'i largohet ...

#### AKTUALITET

## Sherr me menaxherin e lokalit, klienti qëllon me armë në ajër, tenton t'i largohet policisë

**Në prangat e policisë së Elbasanit ka rënë një 41-vjeçari pasi gjatë një sherri me menaxherin e një lokali ka qëlluar me armë zjarri.**



Foto ilustruese

19 Mars, 2019 9:31    **Përditësuar: 10:18**

**Elbasan-** Në prangat e policisë së Elbasanit ka rënë një 41-vjeçar pasi gjatë një sherri me menaxherin e një lokali ka qëlluar me armë zjarri në ajër.

41-vjeçari me initiale B.S ka qëlluar edhe me armë zjarri në ajër në momentin që ka mbritur Policia. Ai ka tentuar të largohet nga vendi i ngjarjes duke hedhur armën e zjarrit në tokë por në këtë moment u arrestua nga policia.

### **Njoftimi i policisë:**

Policia parandalon përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti me pasoja të rënda. Ndërhyrja në kohë e Policisë parandalon një konflikt për motive të dobëta midis menaxherit të një lokali dhe klientit, ku është përdorur edhe arma e zjarrit.

Arrestohet në flagrancë nga Policia një 41 vjeçar, i cili ka qëlluar me armë zjarri në ajër dhe në momentin që ka mbritur Policia, ka tentuar të largohet nga vendi i ngjarjes duke hedhur armën e zjarrit në tokë. 

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Në Sallën Operative të Komisarariatit të Policisë Elbasan , ka ardhur një telefonatë se në lagjen “Viserian Xhuvani”, Elbasan, po ndodh një konflikt në një lokal ku janë dëgjuar dhe të shtëna me armë.

Menjëherë në drejtim të vendngjarjes kanë shkuar shërbimet e policisë, ku falë reagimit të shpejtë të mirëorganizuar, kanë bërë të mundur arrestimin në flagrancë të shtetasit: B.S., 41 vjeç, banues në Elbasan. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan një armë e zjarri pistolet, si dhe një gëzhgjë.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për veprat penale. “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “Prishja e qetësisë publike”.

**J.V/Dosja.al**

DR LIGHT

ETIKETA: [#arrestohet 41-vjeçari](#) [#elbasan](#) [#qëllon me armë](#) [#sherr menaxheri klienti](#)

8

SHARES



Previous article

**Meta publikon videon emocionuese, rrëfen mbresat e takimit me Ansi Agollin: Ambasadori ynë më i mirë**

Next article

**Arti shqiptar në zi, ndahet nga jeta “Artisti i merituar” Shqyqyri Alushi**

Shto Koment

Emri Juaj\*

E-Mail\*

Komenti Juaj\*

